



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Tiranë, më 08.05 2015

Njoftim

Lënda: Zgjatja e afatit për rishikimin e kushteve mjedisore

Agjencia Kombëtare e Mjedisit njofton se afati për aplikimin për rishikimin e kushteve të lejes mjedisore do të vazhdojë deri më datën 09.07.2016.

Operatorët e instalimeve ekzistuese do të vazhdojnë të aplikojnë në QKL për rishikimin e kushteve brenda afatit kohor nga hyrja në fuqi e VKM nr.419 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja.

Kërkuesi që aplikon pranë Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) për pajisjen me leje mjedisi të tipit A dhe B, duhet të dorëzojë këto dokumente:

- a) Formularin informues për pajisje me leje mjedisi të tipit A,B, C sipas shtojcës 1, të vendimit nr 419 ;
- b) Mandatpagesën për tarifën përkatëse në rastet kur Lejen mjedisore e ka marrë pas hyrjes në fuqi të **Vendim Nr.417**, date 25.06.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit” A, B, C.

- c) Çdo informacion tjetër që kërkuesi i lejes kërkon të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit;
- d) Kopjen e Lejes mjedisore e cila merret si e vlefshme vetem nëse është për funksionimin e aktivitetit jo për instalimin
- e) Operatori i një instalimi të tipit A dhe të tipit B që do të kryejë aplikimin për rishikim, njofton AKM-në me shkresë zyrtare dhe përgjigjen e dhënë nga AKM-ja duhet ta bashkangjisë në dosjen e aplikimit.
- f) Planin e përputhshmërisë të plotësuar në mënyrë të detajuar.
- g) Monitorimet e kryera gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit

Për të gjitha pikat e formularit të kërkesës apo dokumentacionin në të cilën kërkohet leja apo licenca që aktiviteti ka duhet të ketë një kopje të lejeve që deklarohen që ka.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

JULIAN BEQIRI

